Овој проект е финансиран од Европската Унија

PERCEPTIMI I TË RINJVE PËR GJENDJEN MJEDISORE NË QYTETIN E GOSTIVARIT

Gjetjet kryesore të hulumtimit



Овој проект е финансиран од Европската Унија

Titulli: Perceptimi i të rinjve për gjendjen mjedisore në qytetin e Gostivarit

Autor: Muhamed Sallmani

Botues: Qendra për zhvillimin e Medieve të Bashkësive MEDIUM

Redaktor: Dobrinka Stojanovska

Raporti është pjesë e programit të subgranteve në kuadër të projektit "Aktivizmi rinor për komunat e gjelbra". Projekti mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e autorit dhe Qendrës për zhvillimin e medieve të bashkësive MEDIUM dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohet si pasqyrim i qëndrimit zyrtar të Bashkimit Evropian.

PERMBAJTJA:

Hyrje 4
METODOLOGJIA 5
1. Gjendja e mjedisit jetësor në Gostivar 5
2. Ndotja e mjedisit jetësor me mbeturina në Gostivar 6
2. Ndotja e ajrit në Gostivar 6
5. Sipërfaqe të gjelbra të pamjaftueshme - parqe në Gostivar 9
6. Qëllimet strategjike dhe masat për kushte më të mira të jetesës dhe standarde 9
5. KËRKIM EMPIRIK 10
5.1. Prezantimi i rezultateve të hulumtimit 10
5.2. Shkaqet kryesore të ndotjes së mjedisit jetësor 12
5.3. Cilësia e mjedisit në komunën e Gostivarit 13
5.4. Zgjidhja e problemit të ndotjes 13
5.5. Informimi i të rinjve për subvencionet e disponueshme për eko ngrohje 14
5.6. A dënohen ndotësit e mjedisit jetësor? 16
5.7. Iniciativat rinore për mbrojtjen e mjedisit 17
5.8. Aplikacion për raportim të ndotjes së mjedisit në komunën e Gostivarit 18
VËZHGIMET PËRFUNDIMTARE 20
BIBLIOGRAFIJA 22
Aneks 1. Anketa për të rinjtë 23

Hyrje

Mjedisi është një nga faktorët më të rëndësishëm që përcakton cilësinë e jetës së qytetarëve. Vitet e fundit, shqetësimet për degradimin e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve dhe pasojat e gjera të ndotjes kanë tërhequr shumë vëmendje në nivel global, rajonal dhe nacional.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si shumë vende të tjera, po përballet me sfida lidhur me mbrojtjen e mjedisit, në zgjidhjen e të cilave të rinjtë duhet të luajnë një rol aktiv. Për përballjen me rreziqet klimatike dhe për një mjedis të shëndetshëm kërkohet edukimi i brezave të rinj dhe zhvillimi i ndërgjegjësimit të tyre mjedisor.

Analiza e fundit e bërë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e publikut në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mjedisin[1], tregon se shumica e qytetarëve (73%) janë të shqetësuar për ndryshimet klimatike dhe ndikimin negativ të tij në cilësinë e jetës së të rinjve. Një përqindje e madhe e popullsisë së re e konsideron ndotjen e ajrit si kërcënimin më të madh mjedisor, ku të rinjtë shfaqin shqetësim më të madh në krahasim me grupmoshat e tjera. Megjithatë, ata janë gjithashtu edhe më të motivuar për të marrë pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit. Sipas këtij hulumtimi, kategoria më aktive e qytetarëve që personalisht kanë ndërmarrë veprime janë të rinjtë e moshës 15 deri në 18 vjeç.

Specifikimi i problemit dhe manifestimit të tij në natyrë, si dhe në të gjithë popullsinë, nuk kërkon më përgjigje për pyetjen: ***a duhet të bëjmë diçka, por çfarë duhet të bëjmë tani?*** Prandaj, në kuadër të këtij hulumtimi, përmes analizës së përgjigjeve të pyetësorit të postuar në platformën digjitale të Google Forms, në të cilin janë përfshirë gjithsej 203 të rinj, do të kemi një pasqyrë të sfidave mjedisore me të cilat përballen të rinjtë në Gostivar. Në të njëjtën kohë do të shohim qëndrimet e tyre për problemet mjedisore, si dhe propozimet e tyre për zgjidhjen e këtij problemi.

Raporti është i disponueshëm vetëm në formë elektronike në faqen e internetit të Qendrës për zhvillimin e medieve të bashkësive – MEDIUM MEDIUM – Center for Media Community development (mediumcenter.mk).

[1] Hulumtim mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mjedisin - https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/izvestai/istrazuvanje-za-znaenjata-stavovite-i-praktikite-vo-vrska-so-klimatskite-promeni

METODOLOGJIA

Për të pasur një pasqyrë të problemeve mjedisore, gjegjësisht sfidave me të cilat përballen të rinjtë në mjedisin ku jetojnë, si dhe për të arritur rezultate objektive në vetë hulumtimin, është zbatuar analiza sasiore dhe cilësore. Për të përcaktuar gjendjen reale faktike me ndotjen në komunën e Gostivarit, është përgatitur dhe realizuar një anketë në të cilën kanë marrë pjesë 203 të rinj të moshës 16 deri në 29 vjeç në platformën digjitale të Google Forms. Përmes anketës janë trajtuar problemet dhe sfidat më thelbësore mjedisore me të cilat ballafaqohen të rinjtë në Gostivar. E njejta u realizua në periudhën nga 25 janari deri më 25 shkurt 2024. Gjithashtu, duke përdorur metodat e hulumtimit në деск, përmes rishikimit të materialeve relevante, duke përfshirë politikat aktuale të komunës së Gostivarit, si Strategjia për Ajër të Pastër dhe Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal. Në të njëjtën kohë, përmes një qasjeje të drejtpërdrejtë me intervista të shkurtra me autoritetet në komunë, u përcaktua niveli i zbatimit të këtyre politikave aktuale, pra investimet e realizuara të parapara në fushën e mjedisit.

Gjetjet relevante dhe informacionet tjera në lidhje me hulumtimin janë paraqitur në tri pjesë brenda këtij Raporti. Në pjesën e parë është përfshirë gjendja e mjedisit të komunës së Gostivarit dhe rëndësia e tij për shëndetin e qytetarëve. Pjesa e dytë përbëhet nga hulumtimi empirik, ku prezantohen gjetjet nga të dhënat e mbledhura nga anketa e realizuar me të rinjtë. Pjesa e tretë përmban vëzhgimet përmbyllëse dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara.

1. Gjendja e mjedisit jetësor në Gostivar

Në zonën e komunës së Gostivarit, ndotja e tokës, ujit dhe ajrit është e pranishme gjatë gjithë vitit.

- Ndotja e tokës ndodh nga përdorimi i plehrave artificiale, kimike dhe substancave të tjera toksike dhe depozitimi i pluhurit dhe grimcave të metaleve të rënda dhe substancave toksike në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë nga ndotësit e pranishëm në këtë zonë.
- Ndotja e ajrit shkaktohet nga gazrat, pluhuri nga objektet industriale dhe prodhuese, ndërtesat e banimit dhe afarizmi, automjetet etj.

- Ndotja e ujit të pijshëm përfshin futjen e ndotësve të ndryshëm në lumenj dhe ujërat nëntokësore.[2]

Mbrojtja e mjedisit dhe e natyrës, në drejtim të marrjes së masave për parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës, është një nga kompetencat themelore që gjendet në Statutin e komunës së Gostivarit[3], por edhe përkundër kompetencave të parapara, gjendja me ndotjen dhe reagimet e shumta të qytetarëve janë të dukshme, dhe komuna është inerte në trajtimin e këtij problemi.

2. Ndotja e mjedisit jetësor me mbeturina në Gostivar

Në Komunën e Gostivarit ekziston dhe funksionon ndërmarrja publike komunale "Komunalec" që kujdeset për grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale. Mbetjet komunale të grumbulluara transportohen dhe depozitohen në deponinë e qytetit "Rusino". Në periferi të qytetit janë shënuar disa deponi të egra, të cilat paraqesin rrezik për mjedisin dhe një prej tyre është deponia "Rusino".

Shumë ndotje mjedisore vijnë edhe nga zonat rurale. Mbeturinat hidhen në rrjedhat ujore dhe lumenjtë e afërt dhe gjatë shirave të rrëmbyeshëm transportohen në lumenjtë Vardar dhe Lakavicë, duke ndotur dhe prishur karakteristikat vizuale dhe peizazhore të zonës. Si problem më i theksuar mjedisor, spikat problemi i ndotjes së tokës dhe ujit me përdorimin e preparateve kimike dhe plehrave artificiale në trajtimin e vreshtave dhe plantacioneve të tjera dhe sipërfaqeve bujqësore.

Ndotja e tillë e mjedisit, konkretisht e tokës, ujit dhe ajrit, paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin dhe jetën e qytetarëve të komunës së Gostivarit.

2. Ndotja e ajrit në Gostivar

Çrregullimi i cilësisë së ajrit është gjithnjë e më i pranishëm në qytete dhe e njëjta gjë ndodh për shkak të aktiviteteve të përditshme njerëzore. Me këtë problem ballafaqohet edhe komuna e Gostivarit, ku ndotje e shtuar e ajrit vërehet në pjesën urbane, përkatësisht në zonën qendrore. Ndotje e konsiderueshme e ajrit regjistrohet veçanërisht në muajt e ftohtë të dimrit, kryesisht për shkak të kushteve atmosferike dhe rritjes së përdorimit të lëndëve djegëse fosile për ngrohjen e amvisërive dhe objekteve të subjekteve juridike publike dhe private.

[2] Plani strategjik për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë e Komunës së Gostivarit 2022 – 2026 - https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/IDSCS_Strateski-Plan_Gostivar_digital_A4_MK.pdf

[3] Statuti i komunës së Gostivarit - https://gostivari.gov.mk/mk/%d1%81%d1%82%d0%b0%d1%82%d1%83%d1%82-%d0%bd%d0%b0-%d0%be%d0%bf%d1%88%d1%82%d0%b8%d0%bd%d0%b0-%d0%b3%d0%be%d1%81%d1%82%d0%b8%d0%b2%d0%b0%d1%80/

Sipas informacioneve të një personi kompetent në komunën e Gostivarit, një analizë e brendshme e bërë nga komuna, me mbështetjen e UNDP-së, tregon se shumica e qytetarëve në Gostivar ngrohen me dru dhe pelet, e shumë rrallë me naftë.

Me qëllim të përcaktimit të kushteve dhe përcaktimit të masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit, komuna e Gostivarit miratoi Strategjinë për ajër të pastër në vitin 2020.[4],dhe e njejta është pjesë e strategjisë së përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit në komunën e Gostivarit dhe pjesë e PLVM[5] (planit lokal të veprimit në mjedis).

Strategjia komunale për ajër të pastër propozon bashkëpunim konstruktiv me industrinë, bizneset e vogla, qeverinë, organizatat joqeveritare mjedisore, sektorin e shëndetësisë dhe me qytetarët për të garantuar mbrojtjen e shëndetit publik dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit jetësor në komunën e Gostivarit.

Përmes qasjes të drejtpërdrejtë, gjegjësisht përmes intervistave të shkurtra me autoritetet e komunës, u konstatua se sipas kësaj strategjie janë realizuar këto aktivitete: subvencionimi i biçikletave, dhënia e subvencioneve për qytetarët për blerjen e kondicionerit inverter, ndërtimi i shtigjeve për biçikleta, mbjelljen e mbi 200 pemëve çdo vit, sigurimi i koshave të mbeturinave në hapësirat publike, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra, përfshirë edhe oborret e institucioneve edukative dhe arsimore, instalimi i sensorëve apo stacioneve matëse për matjen e ndotjes, tabela informative e të tjera.

Programet për reduktimin e ndotjes së ajrit sipas strategjisë për mbrojtjen e ajrit të Gostivarit mund të ndahen në dy kategori: kontroll afatgjatë dhe afatshkurtër (kontrolli i episodeve).

Kontrolli afatshkurtër përfshin zbatimin e zgjidhjeve ligjore të miratuara për mbrojtjen e ajrit dhe zbatimin e masave për efikasitet energjetik të amvisërive dhe bizneseve (të cilat reduktojnë sasinë e lëndëve djegëse të konsumuara për ngrohje). Sapo të konstatohet se ndotja është mbi nivelin e lejuar, ekipet në terren duhet të kontrollojnë menjëherë ndotësit më të mëdhenj - kompanitë me licencë A, pastaj ato me licencë B - dhe të ndalojnë punën e tyre. Më pas duhet të kontrollohen ata që djegin goma, plastikë, kabllo etj.

Në politikat afatgjata për kontrollin e ndotjes së ajrit, më e rëndësishmja është vendosja e filtrave dhe aplikimi i standardeve që kufizojnë përmbajtjen e ndotësve në ajrin e emetuar nga oxhaqet industriale, zhvendosja e ndotësve më të mëdhenj, largimi nga

[4] Strategjia për ajër të pastër në komunën e Gostivarit 2020 - https://gostivari.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/42STRATEGJIA-P%C3%8BR-AJ%C3%8BR-T%C3%8B-PAST%C3%8BR-N%C3%8B-GOSTIVAR-2020-FINAL-mkd.pdf

[5] Strategjia për zhvillimin ekonomik lokal të komunës së Gostivarit për periudhën 2021-2025 - https://gostivari.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/STRATEGIJA-ZA-LER-_GOSTIVAR-2021-2025-FINAL.pdf

qarkullimi i makinave që nuk plotësojnë standardet e mosndotjes së ajrit, ndalimi i përdorimit të substancave të caktuara për djegie (naftë, qymyr, mazut, plastikë, goma, vajra industriale...) në amvisëri private, fabrika, ose punëtori private. Klasifikimi dhe riciklimi i mbetjeve, si dhe mbrojtja fizike e deponisë rajonale dhe instalimi i sensorëve dhe kamerave të alarmit të zjarrit për monitorimin e deponisë.

4. Standarde të pakënaqshme për deponimin e mbetjeve të ngurta

Trajtimi i mbeturinave të ngurta në Komunën e Gostivarit ofrohet për qytetin, vendbanimet periferike dhe disa fshatra më të mëdha. Transporti i mbeturinave kryhet nga ana e Ndërmarrjes Publike "Komunalec" në kuadër të komunës së Gostivarit, e cila ka deponinë e vet për mbeturina, përkatësisht deponinë "Rusino" me sipërfaqe prej 40.000 m2.

Kompania aktualisht po përballet me problemin e deponimit të mbetjeve të ngurta komunale. Deponia komunale "Rusino", e cila gjendet në afërsi të Gostivarit, nuk i plotëson nevojat dhe standardet për deponimin e mbeturinave të ngurta komunale të popullatës së komunës. Banorët e vendbanimit, përveç dorëzimit të mbeturinave të krijuara në ndërmarrjen publike, një pjesë e mirë e tyre i hedhin në vendgrumbullimet e egra në mjedisin e afërt aty pranë, gjë që paraqet trajtim të paorganizuar të mbeturinave dhe kërcënim për shëndetin e qytetarëve.

Në Gostivar qytetarët nuk bëjnë dallim në llojin e mbeturinave që hedhin në kontejnerët e vendosura nga ndërmarrja publike. Për këtë arsye ndërmarrja është e detyruar t'i hedhë mbetjet në deponinë e Rusinos pa bërë seleksionim.

Në pjesën urbane të komunës grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave bëhet dy deri në tre herë në javë. Të dhënat e ndërmarrjes publike për vitin 2021 për sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të transportuara janë si më poshtë: 15,312 tonë në vit për familjet; 6,428 ton në vit për industrinë; 264 ton në vit për sipërfaqet e gjelbra; 2440 ton në vit për mbeturinat e qytetit [6]

Sipas strategjisë kombëtare për menaxhim të mbetjeve[7], problemet në menaxhimin e mbetjeve të ngurta mund të tejkalohen duke futur menaxhimin e integruar rajonal të mbetjeve të ngurta, sipas direktivave të BE-së. Në rajonin e Pollogut, është planifikuar të

[6] Strategjia për zhvillimin lokal ekonimik të komunës së Gostivarit 2021-2025, fq.19 - https://gostivari.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/STRATEGIJA-ZA-LER-_GOSTIVAR-2021-2025-FINAL.pdf

[7] Plani kombëtar për menaxhim të mbetjeve 2020 - 2030 - https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/10/Nacrt-SOZS-NPUO_14.10.2020_v02.pdf

vendoset një menaxhim integral i mbeturinave komunale përmes lëshimit të një koncesioni për menaxhimin e mbetjeve të ngurta komunale.[8]

Rregullimi i sistemit të trajtimit të mbetjeve të ngurta në nivel rajonal do të kontribuojë shumë në grumbullimin dhe transportimin e plotë të këtij lloji mbetjesh në territorin e të gjithë komunës. Në të ardhmen, kjo do të kontribuojë në pastrimin e deponive ekzistuese të egra dhe mbylljen dhe rehabilitimin e tyre, si dhe në mbrojtjen e mjedisit, gjë që do të rrisë cilësinë e ofertës turistike të komunës..

5. Sipërfaqe të gjelbra të pamjaftueshme - parqe në Gostivar

Komuna posedon dhe administron sipërfaqe publike të gjelbra të llojit të parqeve dhe fushave për sport dhe rekreacion. Shumica e tyre janë në territorin e qytetit.

Qyteti ka tre parqe të qytetit të cilat në raport me numrin e banorëve nuk i plotësojnë nevojat e qytetarëve, sepse janë nën normën shtetërore prej m2 gjelbërim për banor. [9] Në bazë të Ligjit për gjelbërim urban janë vendosur standarde dhe norma për planifikimin dhe projektimin e gjelbërimit, të cilat duhet t'i arrijë çdo njësi e vetëqeverisjes lokale. Çdo komunë, në procesin e planifikimit urban, gjatë përgatitjes së Planit të Përgjithshëm Urbanistik, duhet të sigurojë 25 m2 gjelbërim për banor brenda fushëveprimit planifikues të qytetit.[10] Prandaj, në Gostivar nevojitet shumë më shumë gjelbërim që komuna t'i afrohet këtij standardi dhe norme për planifikimin dhe projektimin e gjelbërimit.

6. Qëllimet strategjike dhe masat për kushte më të mira të jetesës dhe standarde

Komuna e Gostivarit në periudhën 2017 - 2020, sipas programeve të buxhetit komunal dhe në përputhje me qëllimet dhe masat strategjike për kushte më të mira të jetesës dhe standarde në raport me mjedisin, komuna e Gostivarit ka realizuar dy projekte mjedisore dhe atë: mbeturinat me buxhet të përgjithshëm prej 2.800.000 denarë dhe dy projekte për efikasitet energjetik të realizuara me buxhet të përgjithshëm prej 6.000.000 denarë.[11] Aktivitetet mbështeten edhe nga organizata dhe fondacione joqeveritare ndërkombëtare.

Në programin për vitin 2024 parashikohen subvencione për blerjen e kondicionerëve inverter dhe subvencionim i qytetarëve për blerjen e biçikletave, ndërsa për efikasitet

[8] https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/07/Regi%D0%BEnalen-plan-za-UO-Polog.pdf
[9] Strategjia për zhvillimin lokal ekonimik të komunës së Gostivarit 2021-2025 - https://gostivari.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/STRATEGIJA-ZA-LER-_GOSTIVAR-2021-2025-FINAL.pdf
[10] Ligji për gjelbërim urban, Neni 19, paragrafi 1.
[11] Strategjia për zhvillimin lokal ekonimik të komunës së Gostivarit 2021-2025 - https://gostivari.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/STRATEGIJA-ZA-LER-_GOSTIVAR-2021-2025-FINAL.pdf

energjetik parashikohen vetëm për objektet për të cilat është përgjegjëse komuna, si cerdhet, shkollat, ndërtesa komunale dhe objektet e ndërmarrjeve publike të themeluara nga komuna.

Është me rëndësi të madhe të theksohet se, që nga fillimi i vitit 2024, Komuna e Gostivarit ka krijuar një sektor për mbrojtjen e mjedisit me dy departamente që janë në proces të plotësimit të personelit.

5. KËRKIM EMPIRIK

5.1. Prezantimi i rezultateve të hulumtimit

Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshinte një pyetësor online ose një anketë me palët e interesuara, përkatësisht me popullatën e re që jeton në komunën e Gostivarit.


Hulumtimi është realizuar me 203 të anketuar të ndarë sipas grupmoshave nga 16 deri në 29 vjeç, në një periudhë prej një muaji. Analiza është bërë me mostrën e synuar nga komuna e Gostivarit.


Nëpërmjet anketës së realizuar, kemi marrë një pasqyrë të qartë të problemeve dhe sfidave mjedisore me të cilat përballen të rinjtë në mjedisin ku jetojnë. Gjithashtu, lexuesit mund të marrin informacion shtesë për qëndrimet dhe propozimet e të rinjve për përmirësimin e mjedisit jetësor.

Struktura e moshes e të rinjve të përfshirë në hulumtim nga gjithsej 203 të anketuar është si vijon: **10.1%** (20) janë nga mosha 0 deri në 16 vjeç, **41.2%** (82) e të anketuarve janë midis moshës 24 vjeç dhe 29. Numri më i madh i të anketuarve janë të moshës 24-29 vjeç, pra **48.7%** (97).

Sa i përket gjinisë së të anketuarve të përfshirë në pyetësor, **59.9%** (121) janë meshkuj dhe **40.1%** (81) janë femra.


Grafiku 1, Struktura e moshës të të anketuarve





Grafiku 2, Gjinia e të anketuarve

Ndarja për sa i përket nivelit arsimor të të rinjve të përfshirë në hulumtim është si vijon: **4.5%** (9) kanë përfunduar shkollën fillore, **42.8%** (86) me arsim të lartë, dhe numri më i madh i të anketuarve, d.m.th. **53.7 %** (108) kanë kryer shkollën e mesme.



Grafiku 3, Niveli i arsimimit të të anketuarve

5.2. Shkaqet kryesore të ndotjes së mjedisit jetësor

Në pyetjen e parë ,,Cilët janë shkaqet kryesore të ndotjes së mjedisit në qytetin tuaj?", sipas mendimit të të anketuarve, ndotësi më i madh i mjedisit në Gostivar janë mbeturinat me **81,6%** (164), pasuar nga industria me **44,3%.** (89) dhe transporti me **40.3%** (81), ndërsa numri më i vogël i të anketuarve, përkatësisht **27.9%** (56), mendojnë se ngrohja e shtëpive është ndotësi kryesor i mjedisit.



Grafiku 4, Shkaqet kryesore të ndotjes së mjedisit

Shumica e të anketuarve mendojnë se mbeturinat dhe industria janë ndotësit më të mëdhenj të mjedisit dhe kjo thekson qartë nevojën për investime në infrastrukturën

mjedisore (kryesisht nëpërmjet vendosjes së më shumë kontejnerëve për deponimin e mbetjeve, si dhe kontejnerëve për përzgjedhjen e mbetjeve) dhe forcimit të kapaciteteve të ndërmarrjes publike N.P Komunalec Gostivar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Sipas përgjigjeve, ekziston gjithashtu një nevojë reale për vendosjen e filtrave dhe aplikimin e standardeve që kufizojnë përmbajtjen e ndotësve në ajër të emetuar nga oxhaqet industriale. Kompanitë e mëdha industriale në fakt kanë obligim ligjor që të vendosin filtrat e nevojshëm dhe të marrin lejet e integruara mjedisore A, të cilat lëshohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Duke vepruar kështu, ata duhet të reduktojnë emetimet gjatë prodhimit, veçanërisht ato që djegin qymyr, naftë ose mazut.

5.3. Cilësia e mjedisit në komunën e Gostivarit

Në pyetjen e dytë, të rinjtë nga Gostivari dhanë mendimin e tyre për cilësinë e mjedisit në qytetin e tyre. Analiza e përgjigjeve tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve të rinj përkatësisht **52.2%** (105) mendojnë se cilësia e mjedisit po përkeqësohet, ndërsa **39.8%** (80) mendojnë se cilësia e mjedisit mbetet e njëjtë. Nga rezultatet del qartë se sa skeptikë janë të rinjtë në Gostivar sa i përket cilësisë së mjedisit, me atë se vetëm **2.5%** (5) besojnë se gjendja është duke u përmirësuar.



Grafiku 5, Cilësia e mjedisit jetësor në vendbanimin tuaj

5.4. Zgjidhja e problemit të ndotjes

Në pyetjen e tretë, të rinjtë nga Gostivari patën mundësinë të zgjedhin disa përgjigje se cila është zgjidhja e ndotjes së mjedisit në qytetin e tyre. Numri më i madh i të rinjve të anketuar, ose gjithsej **81.2%** (164), mendojnë se rritja e sipërfaqes së gjelbër do të ndikonte pjesërisht në përmirësimin e mjedisit. **44.6%** (90) besojnë se vendosja e filtrave në fabrika çon në tejkalimin e këtij problemi, ndërsa **41.1%** (83) besojnë se vendosja e transportit publik do të reduktojë ndotjen. Vetëm **23.3%** (47) janë përgjigjur se ndryshimi i regjimit së vozitjes në zonën qendrore të qytetit do të kontribuonte në uljen e ndotjes së mjedisit.



Grafiku 6, Zgjidhja e problemit të ndotjes së mjedisit

5.5. Informimi i të rinjve për subvencionet e disponueshme për eko ngrohje

Në pyetjen e katërt lidhur me atë se sa janë te informuar të rinjtë se komuna e Gostivarit jep subvencione për eko ngrohje një herë në vit, rezultatet tregojnë se ekziston një shkallë e lartë e mungesës së informacionit, gjegjësisht **70.3%** (142) nuk janë fare të informuar për ekzistimin e subvencioneve të tilla për eko ngrohje, dhe vetëm **13,9%** (28) e të anketuarve janë të informuar për këto subvencione. Këto gjetje theksojnë nevojën për realizimin e një fushatë nga komuna, me të vetmin qëllim që të informohen sa më shumë qytetarët për këto subvencione.



Grafiku 6, Niveli i informimit për subvencionet e dhëna nga komuna e Gostivarit për qytetarët për eko ngrohje


Në pyetjen e pestë, të rinjtë patën mundësi të shprehin mendimet e tyre nëse komuna duhet të japë më shumë subvencione për eko ngrohje. Numri më i madh i të rinjve, **84%** (168), mendojnë se komuna duhet të ofrojë më shumë subvencione për eko ngrohje dhe një përqindje e vogël e parëndësishme, përkatësisht **13%** (26) janë përgjigjur negativisht.



Grafiku 7, Mendimi i të rinjve, a duhet komuna të japë më shumë subvencione për eko ngrohje?

Këto rezultate shprehin qartë interesimin e madh të të rinjve për blerjen e pajisjeve ngrohëse më moderne dhe kjo duhet marrë si sinjal që komuna të siguroj më shumë subvencione për ngrohje ekologjike, e cila do të ndikojë në përmirësimin e mjedisit dhe uljen e kostove të qytetarëve për ngrohje.

Nga ana tjetër, ngrohja si shkaktar kryesor i ndotjes së mjedisit motivon **52.5%** (106) të të rinjve që të ndryshojnë mënyrën e ngrohjes, për të ulur ndotjen. Nga përgjigjet e marra, mund të konstatohet se ka një nivel të konsiderueshëm shqetësimi për çështjet mjedisore tek të rinjtë, ku shumica, përkatësisht më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar, shfaqin gatishmëri për të ndryshuar metodën e ngrohjes.



Grafiku 8, A jeni gati të ndryshoni mënyren e ngrohjes për të ulur ndotjen e mjedisit?

5.6. A dënohen ndotësit e mjedisit jetësor?

Në pyetjen e shtatë, perceptimi i shumicës së të rinjve të anketuar, **70.9%** (144), është se ndotësit nuk ndëshkohen. Vetëm **14.8%** (30) besojnë se ka gjoba, por janë selektive, ndërsa **11.8%** (24) kanë deklaruar se ka gjoba, por nuk paguhen, dhe **12.8%** (26) e të rinjve të anketuar kanë qëndruar të përmbajtur lidhur me këtë çështje. .



Grafiku 9. A mendoni se ndotësit e mjedisit ndëshkohen mjaftueshëm?

Me këtë qëndrim, të rinjtë nga Gostivari shprehin qartë mosbesimin e tyre ndaj institucioneve. Rezultatet tregojnë qartë perceptimin e të rinjve për zbatimin e duhur të ligjeve. Ata nuk kanë besim tek inspektorët e mjedisit në Gostivar.

Përmes qasjes së drejtpërdrejtë me intervista me autoritetet e komunës, u konstatua se në komunën e Gostivarit janë vetëm dy inspektorë për mbrojtjen e mjedisit, të cilët janë pjesë e departamentit të inspektimit.

Gostivari është një komunë që shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 650 kilometra katrorë dhe ka 81.042 banorë, d.m.th. popullsia totale. Nga këtu, është e qartë se ka mungesë të inspektorëve dhe ky numër duhet të rritet. Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për të treguar një proaktivitet më të madh nga ana e inspektorëve në mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, për të ndikuar në rritjen e besimit tek inspektorët dhe puna e tyre, duhet gjetur një mundësi dhe një mënyrë për të informuar të rinjtë për rezultatin e procedurave të nisura kundër ndotësve të mjedisit.

5.7. Iniciativat rinore për mbrojtjen e mjedisit

Analiza e përgjigjeve në pyetjen e tetë është shqetësuese, nëse merret parasysh fakti se më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar, përkatësisht **51.2%** (103) nuk kanë marrë pjesë në asnjë iniciativë për mbrojtjen e mjedisit.



Grafiku 9, A keni qenë ndonjëherë pjesë e një iniciative për mbrojtjen e mjedisit jetësor?

Nga kjo rrjedh se është e nevojshme të zhvillohen punëtori, fushata, për të ndikuar në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e ndikimit të të rinjve për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal. Gjithashtu, me mbajtjen e trajnimeve të ndryshme, duhet të forcohet pjesëmarrja dhe njohuritë e të rinjve për të promovuar dhe avokuar përpara autoriteteve lokale për eko - problemet ekzistuese

Me iniciativën e KRL-së dhe në koordinim me komunën e Gostivarit, në komunën e Gostivarit u krijua Strategjia Lokale për Rini 2023 - 2027 në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen Rinore dhe Politika Rinore. Strategjia parasheh aktivitete që pritet të rezultojnë në përmirësimin e mjedisit në Gostivar.

5.8. Aplikacion për raportim të ndotjes së mjedisit në komunën e Gostivarit

Në pyetjen e fundit, të rinjtë u pyetën nëse do të përdornin një aplikacion online për të denoncuar ndotjen e mjedisit. Grafiku i rezultateve tregon se numri më i madh i të rinjve, d.m.th. gjithsej **76.7%** (155) do të përdornin një aplikacion online, dhe një përqindje e vogël e parëndësishme, përkatësisht **18.3%** (37) nuk do ta përdornin. Përgjigjet pozitive të të rinjve të anketuar në lidhje me gatishmërinë e tyre për të denoncuar rastet e ndotjes së mjedisit, tregon për faktin se është e nevojshme krijimi i një aplikacioni për denoncimin e ndotësve, ku përdoruesit do të kenë mundësinë, me video, foto, datë, orë, vendndodhje. dhe materiale të tjera për të denoncuar ndonjë ndotje të mjedisit në komunën e Gostivarit. Është gjithashtu shumë e rëndësishme brenda aplikacionit, që përdoruesit të informohen për rezultatin e denoncimeve të tyre, gjegjësisht nëse ndotësit janë dënuar.



Grafiku 10. A do të përdornit një aplikacion online për denoncimin e ndotjes së mjedisit?

VËZHGIMET PËRFUNDIMTARE

Nga hulumtimi mund të konstatojmë se rreziku më i madh ekologjik për shëndetin në komunën e Gostivarit është problemi i ndotjes së ajrit dhe menaxhimi i mbeturinave.

Por fatkeqësisht edhe përkundër kësaj situate të dukshme me ndotjen e mjedisit dhe reagimeve të shumta të qytetarëve, komuna është interne për t'u përballur me këtë problem.

Nga ana tjetër, gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se jo vetëm komuna mund të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit, por duhet të ketë bashkëpunim konstruktiv me industrinë, bizneset e vogla, qeverinë, organizatat joqeveritare mjedisore, sektorin e shëndetësisë dhe qytetarët.

Përmes intervistave të realizuara, autoritetet e komunës së Gostivarit konfirmuan se kanë bashkëpunim të ngushtë me sektorin e biznesit dhe janë duke u përpjekur vazhdimisht ta përmirësojnë atë. Gjithashtu, komuna bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare dhe me mbështetjen e tyre zbatojnë synimet dhe masat strategjike për kushte dhe standarde më të mira jetese në raport me mjedisin.

REKOMANDIME

Më poshtë janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin e mjedisit në komunën e Gostivarit:

1. Shumica e të anketuarve besojnë se mbeturinat dhe industria janë ndotësit më të mëdhenj të mjedisit jetësor. Prandaj nevojiten investime në infrastrukturën mjedisore (kryesisht përmes vendosjes së më shumë kontejnerëve për deponimin e mbeturinave dhe kontejnerëve për seleksionimin e mbeturinave) dhe forcimi i kapaciteteve të N.P Komunalec Gostivar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Për sa i përket industrisë, nevojitet më shumë kontroll për zbatimin e duhur të standardeve të reduktimit të ndotjes që rrjedhin nga oxhaqet industriale dhe nga oxhaqet më të mëdha me licencë B të integruar ekologjikisht.
2. Edukimi i qytetarëve dhe subjekteve juridike për aplikimin e mekanizmave të duhur për uljen e ndotjes së mjedisit. Njoftimi i popullatës përmes mediave publike dhe rrjeteve sociale se do të merren masat e duhura në rast të veprimit në kundërshtim me dispozitat ligjore.
3. Mbajtja e trajnimeve të ndryshme në shkolla dhe fakultete, me qëllim forcimin e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e njohurive të të rinjve për të promovuar dhe avokuar para autoriteteve lokale për problemet aktuale mjedisore.

4. Sigurimi i më shumë subvencioneve për eko - ngrohje, që do të ndikojë në përmirësimin e mjedisit jetësor dhe uljen e shpenzimeve të qytetarëve për ngrohje. Gjithashtu, me qëllim që sa më shumë të rinjë të jenë të informuar për këto subvencione, nevojitet një fushatë më e gjerë nga komuna, përkatësisht njoftim përmes rrjeteve sociale dhe mediave lokale.
5. Komuna duhet të mbështesë qytetarët dhe organizatat joqeveritare në luftën kundër ndotjes së mjedisit dhe ajrit.
6. Masa urgjente për rehabilitimin e deponisë rajonale “Rusino” me kushte minimale teknike për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Europian.
7. Rritja e numrit të inspektorëve të mjedisit. Informimi i të rinjve dhe të gjithë qytetarëve në përgjithësi për rezultatin e denoncimeve të iniciuara kundër ndotësve të mjedisit.
8. Është e nevojshme të krijohet një aplikacion për raportimin e ndotësve, ku përdoruesit do të kenë mundësi, me video, fotografi, datë, orë, vendndodhje dhe materiale të tjera, të denoncoj çdo ndotje të mjedisit në komunën e Gostivarit.
9. Është e domosdoshme ngritja e Kadastrës për mjedisin jetësor (e cila përmban Regjistrin e ndotësve në përputhje me nenin 42 pika 5 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit). Me përpilimin e kadastrës së ndotësve, Gostivari pritet të ketë të dhëna se cilët janë ndotësit dhe sa kontribuojnë në ndotjen e mjedisit. Në këtë mënyrë në të ardhmen do të ndihmojë për të gjetur burimin e ndotjes dhe për të vepruar në përputhje me rrethanat
10. Të ndahet një fond adekuat për përmirësimin e mjedisit, i cili është edhe në përputhje me Strategjinë për ajër të pastër të komunës së Gostivarit, në vlerë prej 1.000.000 euro. Nga këto mjete komuna duhet të ndajë 5% të buxhetit komunal, ndërsa pjesën tjetër duhet ta sigurojë Qeveria e RMV-së.

Komuna e Gostivarit duhet të ndërmarrë aktivitete për realizimin e këtyre rekomandimeve. Në këtë mënyrë do të mundësohet përmirësimi i gjendjes aktuale me mjedisin jetoësor

BIBLIOGRAFIJA

1. Hulumtim mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mjedisin

2. Plani strategjik për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë e Komunës së Gostivarit 2022-2026

3. Statuti i komunës së Gostivarit

4. Strategjia për ajër të pastër në komunën e Gostivarit 2020

5. Plani kombëtar për menaxhim të mbetjeve 2020-2030

6. Strategjia për zhvillimin ekonomik lokal të komunës së Gostivarit për periudhën 2021-2025

Aneks 1. Anketa për të rinjtë

Kjo anketë është e dedikuar për të rinjtë në Gostivar, për të marrë një pasqyrë të problemeve mjedisore, sfidave me të cilat ballafaqohen të rinjtë në mjedisin ku jetojnë. Gjithashtu, me anketën do të shohim pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me atë se cfarë mendojnë se është zgjidhja për zgjidhjen e këtij problemi shumëvjecar.

Të dhënat e marra janë anonime dhe do t'i përdorim për qëllimet e projektit "Qytet i pastër për një të ardhme të pastër", të realizuar nga Qendra për Zhvillimin e Mediave të Bashkësive MEDIUM-Gostivar

Gjinia:

- Mashkullore; Femërore; Nuk edij.

Arsimi:

- Fillorë; Mesëm; i Lartë.

Mosha:

- Deri në 16 vjet; 17-24 vjeç; 24 - 29 vjeç.

Sipas jush, cilat janë shkaqet kryesore të ndotjes së mjedisit në qytetin tuaj? (të mundshme janë më shumë se një përgjigje.)

- Ngrohje shtëpiake
- Industria (Deponia Rusino)
- Mbeturinat
- Transport

Në përgjithësi, krahasuar me vitin e kaluar, a mendoni se cilësia e mjedisit në vendbanimin tuaj

- Është duke u përmirësuar
- Po përkeqësohet
- Mbetet e njëjtë
- Nuk e di

Sipas jush, cila është zgjidhja e problemit të ndotjes së mjedisit në qytetin tuaj?

- Rritja e sipërfaqes së gjelbër
- Vendosja e transportit publik
- Vendosja e filtrave nëpër fabrika
- Ndryshimi i regjimit së vozitjes në zonën qendrore të qytetit

A jeni të informuar se komuna e Gostivarit një herë në vit jep subvencione për qytetarët për eko – ngrohje.

- Po
- Jo
- Nuk edij

Sipas jush, a mendoni se komuna duhet të japë më shumë subvencione për eko – ngrohje ?

- Po
- Jo
- Nuk edij

Nëse është e nevojshme, a jeni gati të ndryshoni llojin e ngrohjes për të reduktuar ndotjen e mjedisit?

- Po
- Jo
- Ndoshta

A mendoni se ndotësit e mjedisit jetësor ndëshkohen mjaftueshëm?

- Nuk ndëshkohen
- Dënime ka, por janë selektive
- Ka gjoba, por nuk paguhen
- Nuk edij

A keni qenë ndonjëherë pjesë e një iniciative për mbrojtjen e mjedisit jetësor?

- Po
- Jo

A do të përdornit një aplikacion online për të denoncuar ndotjen e mjedisit jetësor?

- Po
- Jo
- Nuk edij



Qendra për Zhvillimin e Medieve të Bashkësive

MEDIUM Gostivar

Rruga: Bulevar Braça Ginovski nr. 61 Gostivar
Email: community.mediadev@gmail.com
Web faqja: https://mediumcenter.mk/